



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.legjislacioni.gov.al

Nr. 47

Datë 9 prill 2014

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 23/2014 datë 20.3.2014	Për disa ndryshime në ligjin nr. 8246, datë 1.10.1997, “Për Institutin e Integritit të të Përndjekurve”, të ndryshuar	1263
Ligj nr. 24/2014 datë 20.3.2014	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”	1263
Ligj nr. 25/2014 datë 20.3.2014	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe kulturën”	1264
Ligj nr. 26/2014 datë 20.3.2014	Për disa ndryshime në ligjin nr. 138/2013, “Për burimet e energjisë së rinovueshme”	1265
Ligj nr. 27/2014 datë 20.3.2014	Për ratifikimin e protokollit shtesë 3 të marrëveshjes për amendimin dhe aderimin në marrëveshjen e tregtisë së lirë të Europës Qendrore	1265
Ligj nr. 28/2014 datë 20.3.2014	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Europiane (EUROPOL) për bashkëpunimin strategjik dhe operacional	1266
Udhëzim i MF nr. 6/3, datë 8.4.2014	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 17, datë 13.5.2008, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar	1274

LIGJ
Nr. 23/2014

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8246,
DATË 1.10.1997, “PËR INSTITUTIN E
INTEGRIMIT TË TË PËRNDJEKURVE”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8246, datë 1.10.1997, “Për Institutin e Integritimit të të Përndjekurve”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 1

Instituti i Integritimit të të Përndjekurve (IIP), si institucion shtetëror në varësi të Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ka për qëllim të marrë të gjitha masat dhe të ndjekë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me integritimin në jetën e shoqërisë shqiptare të ish të përndjekurve politikë nga regjimi komunist.”.

Neni 2

Neni 3 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 3

Struktura dhe organika e IIP-së miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ndërsa rregullorja e funksionimit të institutit miratohet nga Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Drejtori i IIP-së emërohet dhe shkarkohet nga Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, pasi merret mendimi i shoqatave të të përndjekurve.”.

Neni 3

Neni 4 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 4

Për të siguruar veprimtarinë e tij, IIP-ja mbështetet në një fond buxhetor, i cili miratohet si zë i veçantë në buxhetin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

IIP-ja mund të sigurojë burime financiare edhe nëpërmjet donacioneve e projekteve të ndryshme nga donatorë vendas e të huaj ose edhe nga çdo burim tjetër i ligjshëm.

Të gjitha donacionet ose të ardhurat e tjera të ligjshme, që i vijnë IIP-së, përdoren vetëm për qëllimet, për të cilat është krijuar ky institut.

IIP-ja informon dhe i raporton Ministrin të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për të gjitha të ardhurat financiare që sigurohen nga cilido burim.”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 20.3.2014

Shpallur me dekretin nr. 8526, datë 3.4.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ
Nr. 24/2014

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË
LIGJIN NR. 10 192, DATË 3.12.2009, “PËR
PARANDALIMIN DHE GODITJEN E KRIMIT TË
ORGANIZUAR DHE TRAFIKIMIT NËPËRMJET
MASAVE PARANDALUESE KUNDËR PASURISË”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Titulli i ligjit ndryshohet si më poshtë:

“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Neni 2

Në nenin 3, pas shkronjës “d”, të paragrafit të parë, shtohet shkronja “dh” me këtë përmbajtje:

“dh) kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet 164/a, 244, 244/a, 245, 260, 312, 319 dhe 319/ç të Kodit Penal.”.

Neni 3

Kudo në këtë ligj fjalët “krimi i organizuar dhe trafikimi” zëvendësohen me fjalët “krimi i organizuar, trafikimi dhe korrupsioni”.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 20.3.2014

Shpallur me dekretin nr. 8530, datë 3.4.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ
Nr. 25/2014

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË LIGJIN NR. 10 352, DATË 18.11.2010,
“PËR ARTIN DHE KULTURËN”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe kulturën”, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 5, pika 3, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “ç” shfuqizohet.
2. Shkronja “e” ndryshohet si më poshtë:
“e)Teatri kombëtar eksperimental “Kujtim Spahivogli””.

Neni 2

Neni 14 shfuqizohet.

Neni 3

Kreu IV, “Organizimi dhe funksionimi i Qendrës Kombëtare të Artit dhe Kulturës”, shfuqizohet.

Neni 4

Neni 26 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 26

Financimi i projekteve dhe veprimtarive artistike e kulturore

1. Ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën, nga fondi buxhetor i miraturar për çdo vit, financon:

a) projekte të paraqitura nga persona fizikë, juridikë, vendas ose të huaj, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre artin dhe kulturën;

b) projekte dhe veprimtari artistike e kulturore, të cilat konsiderohen të rëndësishme së veçantë dhe që kanë një buxhet që arrin mbi 40 për qind të fondit vjetor për projekte.

1264

2. Ky fond nuk i nënshtrohet legjislacionit të prokurimit publik.

3. Procedurat, që ndiqen për financimin e projekteve artistike, sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij neni, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 5

Neni 27 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 27

Miratimi i veprimtarive artistike e kulturore

1. Miratimi i veprimtarive artistike e kulturore për artin dhe kulturën bëhet nga ministri përgjegjës për artin dhe kulturën, me propozimin e kolegjiut, të përbërë nga:

a) personalitete të gjinive të ndryshme të artit, të përcaktuara me urdhër të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën;

b) nëpunës civilë të nivelit të lartë dhe të mesëm, drejtues të strukturave përgjegjëse, që mbulojnë secilën nga gjinitë e artit në ministrinë përgjegjëse për artin dhe kulturën.

2. Kriteret dhe afatet në lidhje me kërkesë-propozimet për mbështetje financiare, të parashikuara në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 26, përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën.”.

Neni 6

Pas nenit 27 shtohet neni 27/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 27/1

Kompetencat e kolegjiut

1. Kolegjiuti ka këto kompetenca:

a) përzgjedh dhe klasifikon projektet e artit nga pikëpamja e vlerave artistike, kulturore, edukative sociale dhe ekonomike;

b) miraton veprimtari artistike-kulturore për artin dhe kulturën, në përputhje me përcaktimet e bëra në nenin 26 të këtij ligji;

c) nxit krijimtarinë artistike kombëtare dhe i propozon ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën organizimin e konkurseve kombëtare dhe skema të tjera vlerësimi në gjini të ndryshme të artit.

2. Mënyra e funksionimit të kolegjiut përcaktohet me urdhër të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën.”.

Neni 7

Kreu VII, “Subjektet private të artit dhe kulturës”, shfuqizohet.

Neni 8

Në nenin 34, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën, në zbatim të politikave të saj, organizon konkurse kombëtare dhe skema të tjera vlerësimi në gjini të ndryshme të artit. Kushtet dhe masa e shpërblimit të fituesit përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën.”.

Neni 9

Dispozita kalimtare dhe të fundit

Aktet nënligjore që bien në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 20.3.2014

Shpallur me dekretin nr. 8531, datë 3.4.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ

Nr. 26/2014

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 138/2013, “PËR BURIMET E ENERGISË SË RINOVUESHME”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 138/2013, “Për burimet e energjisë së rinovueshme”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 27 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikat 1, 3 dhe 4, fjalët “brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji” zëvendësohen me fjalët “brenda datës 1.1.2015”.

2. Në pikat 2 dhe 5, fjalët “brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji” zëvendësohen me fjalët “brenda datës 1.1.2015”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 20.3.2014

Shpallur me dekretin nr. 8532, datë 3.4.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ

Nr. 27/2014

PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT SHITESË 3 TË MARRËVESHJES PËR AMENDIMIN DHE ADERIMIN NË MARRËVESHJEN E TREGTISË SË LIRË TË EUROPËS QENDRORE

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet protokollin shtesë 3 i marrëveshjes për amendimin dhe aderimin në marrëveshjen e tregtisë së lirë të Europës Qendrore.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 20.3.2014

Shpallur me dekretin nr. 8533, datë 3.4.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

PROTOKOLL SHITESË 3

**I MARRËVESHJES PËR NDRYSHIMIN DHE
ADERIMIN NË MARRËVESHJEN E TREGTISË SË
LIRË PËR EUROPËN QENDRORE**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Bosnja dhe Hercegovina (më poshtë të quajtura “Palët”);

Duke pasur parasysh marrëveshjen për ndryshimet dhe aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë për Europën Qendrore, të nënshkruar në Bukuresht, më 19 dhjetor (më poshtë e quajtur “CEFTA 2006”) dhe shkëmbimin e letrave të ministrit të Tregtisë së Jashtme dhe Marrëdhëniet Ekonomike të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të Republikës së Shqipërisë;

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Në aneksin 3 të nenit 10, paragrafi 1 i CEFTA 2006: Aneksi 3.1 Tabela I: kolona e katërt (Bosnja dhe Hercegovina) fshihet.

Aneksi 3.2 Tabela I: kolona e tretë (Shqipëria) fshihet.

Palët heqin të gjitha detyrimet doganore për importet, të gjitha tarifatat që kanë një efekt të barasvlershëm dhe të

gjitha detyrimet e importit të një natyre fiskale ndërmjet tyre nga data e hyrjes në fuqi të këtij protokollit shtesë.

Neni 2

1. Ky protokoll shtesë i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose aprovimit në pajtim me kërkesat e parashikuara nga legjislativi i brendshëm. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose aprovimit depozitohen te depozituesi.

2. Ky protokoll shtesë hyn në fuqi në ditën e tridhjetë nga depozitimi i instrumentit të fundit të ratifikimit, pranimit ose aprovimit.

3. Kërkesat kushtetuese lejojnë që secila palë të zbatojë përkohësisht këtë protokoll shtesë. Zbatimi i përkohshëm i këtij protokollit shtesë, në pajtim me këtë paragraf, i njoftohet depozituesit.

Në dëshmi të kësaj, të plotfuqishmit e poshtëshënuar, duke qenë rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë protokoll shtesë.

Bërë në Bruksel/Sarajevë _____, në një kopje të vetme autentike në gjuhën angleze, e cila depozitohet te depozituesi i marrëveshjes së tregtisë së lirë për Europën Qendrore, e cila u transmeton kopje të vërtetuara të gjitha palëve.

LIGJ Nr. 28/2014

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE ZYRËS SË POLICISË EUROPIANE (EUROPOL) PËR BASHKËPUNIMIN STRATEGJIK DHE OPERACIONAL

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Europiane (EUROPOL) për bashkëpunimin strategjik dhe operacional.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 20.3.2014

Shpallur me dekretin nr. 8534, datë 3.4.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE

NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE ZYRËS SË POLICISË EUROPIANE (EUROPOL) MBI BASHKËPUNIMIN STRATEGJIK DHE OPERACIONAL

Republika e Shqipërisë dhe Zyra e Policisë Europiane (Europol), më poshtë të quajtura “Palët kontraktuese”, të vetëdijshëm për problemet urgjente që lindin nga krimi i organizuar ndërkombëtar, veçanërisht nga terrorizmi dhe forma të tjera të krimeve të rënda;

duke marrë në konsideratë faktin se Bordi Menaxhues i Europolit, në zbatim të përfshirjes së Republikës së Shqipërisë në vendimin e Këshillit që përcakton listën e shteteve të treta dhe organizatave me të cilat Europol lidh marrëveshje, i ka dhënë Zyrës së Policisë Europiane (më poshtë e quajtur “Europol”) autorizimin për të hyrë në bisedime për një marrëveshje bashkëpunimi me Republikën e Shqipërisë në datën 24 nëntor 2012,

duke marrë në konsideratë faktin se Këshilli i Bashkimit Europian, në mbledhjen e tij të datës 5-6 dhjetor 2013, i ka dhënë Europolit autorizimin për të rënë dakord me marrëveshjen aktuale ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Europolit,

në përputhje me detyrimet e Europolit, sipas Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian,

duke qenë të vetëdijshëm për detyrimet e Republikës së Shqipërisë ndaj Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe detyrimeve të tjera ndërkombëtare relevante, kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është vendosja e marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërmjet Europolit dhe Republikës së Shqipërisë, në mënyrë që të mbështesë shtetet anëtare të Bashkimit Europian dhe Republikën e Shqipërisë në parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe formave të tjera të krimit ndërkombëtar në fushat e krimit, që i referohet nenit 3, në veçanti përmes shkëmbimit të informacionit ndërmjet Europolit dhe Republikës së Shqipërisë.

Neni 2 Përkufizimet

Për qëllim të kësaj Marrëveshjeje:

a) “Vendimi i Këshillit të Europolit” do të thotë vendimi i Këshillit, i datës 6 prill 2009, në bazë të të cilit është krijuar Zyra e Policisë Europiane (Europol), FZ L 121, 15.5.2009;

b) “Të dhëna personale” do të thotë çdo e dhënë e lidhur me një person fizik të identifikuar apo të identifikueshëm: një person i indentifikueshëm, është

personi që mund të identifikohet, drejtpërdrejt apo tërthorazi, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një apo më shumë faktorëve specifikë për identitetin e tij social, kulturor, ekonomik, mendor, fiziologjik ose fizik;

c) “Përpunimi i të dhënave personale” (i quajtur më poshtë “përpunim”) do të thotë çdo operacion apo grup operacionesh, i cili kryhet mbi të dhënat personale, nëpërmjet mjeteve automatike, si për shembull: mbledhja, regjistrimi, organizimi, ruajtja, përshtatja apo ndryshimi, korrigjimi, konsultimi, përdorimi, zbulimi me anë të transmetimit, përhapjes apo duke bërë të vlefshëm koordinimin ose kombinimin, bllokimin, fshirjen apo shkatërrimin;

d) “Informacion” do të thotë të dhëna personale dhe jopersonale.

KREU I QËLLIMI

Neni 3 Fushat e krimit

1. Bashkëpunimi, siç është përcaktuar në këtë Marrëveshje, lidhet me të gjitha fushat e krimit sipas mandatit të Europolit, të klasifikuar në aneksin I, duke përfshirë vepra penale që kanë lidhje me to.

2. Veprat penale të lidhura janë veprat penale të kryera, me qëllim për të siguruar mjetet e kryerjes së akteve kriminale, të përmendura në paragrafin 1, vepra penale të kryera për të lehtësuar apo për të zbatuar akte të tilla dhe vepra penale të kryera për të garantuar pandëshkueshmërinë e këtyre akteve.

3. Kur mandati i Europolit, që është listuar në aneksin I, ndryshohet nga data kur ndryshimi i mandatit të Europolit të hyjë në fuqi, Europoli sugjeron zbatueshmërinë e kësaj Marrëveshjeje sa i takon mandatit të ri ndaj Republikës së Shqipërisë, në formë të shkruar, në përputhje me nenin 25.

Neni 4 Fushat e bashkëpunimit

Bashkëpunimi, përveç shkëmbimit të informacionit, në përputhje me detyrat e Europolit, ashtu siç është përcaktuar në vendimin e Këshillit të Europolit, mund të përfshijë shkëmbimin e njohurive të specialistëve, raportet e përgjithshme të situatave, rezultatet e analizës strategjike, informacion mbi procedurat e hetimit penal, informacion mbi metodat e parandalimit të krimit, pjesëmarrje në aktivitetet e trajnimit, si edhe dhënien e konsulencës dhe mbështetjes për hetimet penale individuale.

Neni 5 Marrëdhënia me instrumente të tjera ndërkombëtare

Kjo Marrëveshje nuk duhet të cenohet apo ndikohet të dispozitat ligjore në lidhje me shkëmbimin e informacionit,

të parashikuar nga ndonjë marrëveshje për ndihmë të ndërsjellë juridike ose marrëveshje apo masë tjetër bashkëpunimi, apo marrëdhënie bashkëpunimi në fushën e zbatimit të ligjit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe çdo shteti anëtar të Bashkimit Europian.

KREU II MËNYRA E BASHKËPUNIMIT

Neni 6 Pika kombëtare e kontaktit

1. Republika e Shqipërisë cakton një pikë kombëtare kontakti për të vepruar si pika qendrore e kontaktit ndërmjet Europolit dhe autoriteteve kompetente të Republikës së Shqipërisë.

2. Shkëmbimi i informacionit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Europolit, të përcaktuar në këtë Marrëveshje, zhvillohet ndërmjet Europolit dhe pikës kombëtare të kontaktit. Megjithatë, kjo nuk përjashton shkëmbime të drejtpërdrejta informacioni ndërmjet Europolit dhe autoriteteve kompetente, siç është parashikuar në nenin 7, nëse çmohet e nevojshme nga të dyja palët.

3. Pika kombëtare e kontaktit do të jetë, gjithashtu, pika qendrore e kontaktit për sa i përket rishikimit, korrigjimit dhe/ose fshirjes së të dhënave personale, siç përmendet në nenin 14.

4. Pika kombëtare e kontaktit do të jetë edhe pika qendrore e kontaktit për Europolin për transmetimin e të dhënave personale nga palët private, të vendosura në Republikën e Shqipërisë, si edhe për informacionin nga personat privatë rezidentë në Republikën e Shqipërisë.

5. Republika e Shqipërisë i jep mundësinë një pike kontakti të lejojë shkëmbimin e informacionit në 24 orë. Pika kombëtare e kontaktit garanton që informacioni të mund të shkëmbihet pa vonesë me autoritetet kompetente, të përmendura në nenin 7.

6. Pika kombëtare e kontaktit për Republikën e Shqipërisë përcaktohet në aneksin II.

Neni 7 Autoritetet kompetente

1. Autoritetet kompetente janë të gjitha organet publike, ekzistuese në Republikën e Shqipërisë, përgjegjëse sipas ligjit kombëtar për parandalimin dhe luftimin e veprave penale. Këto janë renditur në aneksin II të kësaj Marrëveshjeje.

2. Pa cenuar nenin 11, transmetimi i informacionit nga Europoli për Republikën e Shqipërisë dhe transmetimi brenda Republikës së Shqipërisë, duhet të kufizohet për autoritetet kompetente të përmendura.

Neni 8

Konsulencat dhe bashkëpunimi i ngushtë

1. Palët bien dakord që për të zgjeruar bashkëpunimin, të forcuar, si dhe për të monitoruar zhvillimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, shkëmbime të rregullta, sipas rastit, janë thelbësore. Në mënyrë më specifike:

a) Takime të nivelit të lartë, ndërmjet autoriteteve kompetente të Republikës së Shqipërisë dhe Europolit, duhet të zhvillohen rregullisht për të diskutuar çështjet në lidhje me këtë Marrëveshje dhe bashkëpunimin në përgjithësi;

b) Një përfaqësues i pikës kombëtare të kontaktit dhe Europolit do të konsultohen me njëri-tjetrin rregullisht mbi çështjet policore dhe çështjet e interesit të përbashkët për të realizuar objektivat e tyre dhe për të bashkërenduar aktivitetet e tyre përkatëse;

c) Një përfaqësues i pikës kombëtare të kontaktit mund të ftohet të marrë pjesë në takimin e drejtuesve të njëjësive kombëtare të Europolit.

2. Sipas rastit, konsultimi duhet të organizohet në nivelin e kërkuar ndërmjet përfaqësuesve të autoriteteve kompetente të Republikës së Shqipërisë dhe Europolit, përgjegjëse për fushat e kriminalitetit në të cilat zbatohet kjo Marrëveshje, për të rënë dakord mbi mënyrën më efektive me të cilën do të organizohen aktivitetet e tyre të veçanta.

Neni 9

Oficerët ndërlidhës

Palët bien dakord për të rritur bashkëpunimin e përcaktuar në këtë Marrëveshje përmes caktimit të oficerëve ndërlidhës të Republikës së Shqipërisë, për Europolin. Europolit mund të marrë në konsideratë, sipas diskrecionit të tij, caktimin e oficerëve të kontaktit për Republikën e Shqipërisë, të vendosur në pikat kombëtare të kontaktit.

1. Detyrat, të drejtat dhe detyrimet e oficerëve ndërlidhës ndaj autoritetit organizues, numri i tyre, si dhe informacionet e hollësishme në lidhje me vendosjen e tyre dhe kostot e përfshira, janë të përcaktuara në aneksin III.

2. Autoriteti pritës duhet të marrë masat për të gjitha mjetet e nevojshme, si për shembull, ambientet e zyrës dhe pajisjet e telekomunikacionit, të cilat do t'u sigurohen oficerëve ndërlidhës në ambientet e tyre, me shpenzimet e tyre. Megjithatë, kostoja e telekomunikacionit duhet të përballohet nga autoriteti caktues.

3. Arkivat e oficerit(ve) ndërlidhës janë të pacenueshme nga çdo ndërhyrje e zyrtarëve të autoritetit pritës. Këto arkiva duhet të përfshijnë të gjitha të dhënat, korrespondencën, dokumentet, dorëshkrimet, të dhënat kompjuterike, fotografitë, filmimet dhe regjistrimet, të cilat u përkasin apo mbahen nga oficerët ndërlidhës.

4. Autoriteti caktues duhet të garantojë që oficerët e tij ndërlidhës të kenë akses të shpejtë dhe kur është teknikisht e mundur, akses të drejtpërdrejtë në bazën e të dhënave kombëtare, të nevojshme për ta, për të përmbushur detyrat e tyre përkatëse.

5. Europolit do të asistojë Republikën e Shqipërisë për atë kohë sa të ketë mundësi, për sa i përket lidhjes së një marrëveshjeje me Mbretërinë e Holandës, në lidhje me privilegjet dhe imunitetet, të gëzuara nga oficerët ndërlidhës të Republikës së Shqipërisë, të caktuar në Europol. Brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, një oficer ndërlidhës i Europolit do të gëzojë të njëjtat privilegje dhe imunitete, si ato të vendosura nga Republika e Shqipërisë për anëtarët, duke pasur një rang të krahasueshëm me atë të stafit të misioneve diplomatike, të vendosura në Republikën e Shqipërisë.

KREU III

SHKËMBIMI I INFORMACIONIT

Neni 10

Dispozitat e përgjithshme

1. Shkëmbimi i informacionit ndërmjet palëve do të bëhet vetëm për qëllim të dhe në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe në përputhje me kuadrin ligjor të aplikueshëm respektivisht.

2. Transmetimi i të dhënave personale dhe i informacionit të klasifikuar nga Europolit mund të jetë i nevojshëm në rastet individuale, për qëllim parandalimin apo luftën kundër veprave penale, ashtu siç është referuar në nenin 3.

3. Palët duhet t'i japin njëra-tjetrës vetëm informacion, i cili është mbledhur, ruajtur dhe transmetuar në përputhje me kuadrin përkatës ligjor dhe nuk është përfutur në shkelje të hapur të të drejtave të njeriut. Në këtë kontekst, Europolit, në veçanti, do të kufizohet nga neni 20(4) i vendimit të Këshillit, i cili miraton rregullat zbatuese që rregullojnë marrëdhëniet e Europolit me partnerët, duke përfshirë shkëmbimin e të dhënave personale dhe informacionin e klasifikuar.

4. Individët kanë të drejtë të marrin informacionin në lidhje me ta, të transmetuar mbi bazën e kësaj Marrëveshjeje, në përputhje respektivisht me ligjin kombëtar për mbrojtjen e të dhënave të Republikës së Shqipërisë dhe me vendimet e Këshillit të Europolit, dhe për kontrollimin, korrigjimin apo fshirjen e informacionit.

Në rastet kur ushtrohet kjo e drejtë, pala transmetuese do të konsultohet para se të merret një vendim përfundimtar mbi kërkesën e bërë.

5. Kërkesat për akses publik nga individët tek informacioni i transmetuar, mbi bazën e kësaj Marrëveshjeje, duhet t'i parashtrahet palës transmetuese për konsultim sa më shpejt që të jetë e mundur. Informacioni përkatës nuk duhet të zbulohet nëse pala transmetuese mund ta kundërshtojë atë.

Neni 11

Transmetimi i të dhënave personale

1. Kërkesat nga palët për të dhënat personale, duhet të shoqërohen me një shpjegim që tregon qëllimin dhe arsyen e kësaj kërkesë.

2. Në mungesë të një shpjegimi, ashtu siç është përmendur në paragrafin 1, palëve nuk u lejohet të transmetojnë të dhënat personale.

3. Palët duhet të tregojnë në kohën e transmetimit të të dhënave personale ose më parë, qëllimin për të cilin janë transmetuar të dhënat dhe çdo kufizim mbi përdorimin, fshirjen apo shkatërrimin e tyre, duke përfshirë kufizime të mundshme të aksesit në terma specifike apo të përgjithshëm. Kur nevoja për kufizime të tilla bëhet e dukshme pas pajisjes, palët duhet të informojnë për këto kufizime në një kohë të mëvonshme.

Neni 14

Ruajtja, rishikimi, korrigjimi dhe fshirja e të dhënave personale

1. Palët duhet të ruajnë të dhënat personale vetëm për atë kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimin për të cilin ato transmetohen. Nevoja për ruajtje të vazhdueshme duhet të rishikohet jo më vonë se tre vjet nga transmetimi.

Gjatë rishikimit, palët mund të vendosin mbi ruajtjen e vazhdueshme të të dhënave deri në rishikimin pasues, i cili duhet të ndodhë në një periudhë tjetër pas tre vjetësh, nëse është ende e nevojshme për kryerjen e detyrave të tyre. Nëse nuk është marrë asnjë vendim mbi ruajtjen e vazhdueshme të të dhënave, këto të dhëna duhet të fshihen automatikisht.

2. Kur njëra palë ka arsye për të besuar se të dhënat personale, që janë transmetuar më parë, janë të pasakta, të parregullta, të papërditësuara apo nuk duhen transmetuar, duhet të informojë palën tjetër, e cila duhet të korrigojë apo të fshijë të dhënat personale dhe të japë njoftim në lidhje me këtë.

3. Kur njëra palë ka arsye për të besuar se të dhënat personale të marra janë të pasakta, të parregullta, të papërditësuara apo nuk duhen të ishin transmetuar, duhet të informojë palën tjetër, e cila duhet të japë qëndrimin e saj mbi këtë çështje.

4. Në rastet kur Europol i njoftohet mbi korrigjimin dhe fshirjen e të dhënave të marra nga Republika e Shqipërisë, megjithatë mund të vendosë të mos ta fshijë informacionin, në rast se informacioni i ndodhur në dosje është më i zgjeruar se ai që posedon Republika e Shqipërisë, dhe është i nevojshëm shqyrtimi i mëtejshëm i tij. Europol duhet të informojë Republikën e Shqipërisë për ruajtjen e mëtejshme të këtij informacioni.

Neni 15

Vlerësimi i burimit dhe i informacionit

1. Kur informacioni sigurohet nga palët, mbi bazën e kësaj Marrëveshjeje, burimi i informacionit do të përcaktohet sa më shumë të jetë e mundur në bazë të kritereve të mëposhtme:

a) Kur nuk ka dyshim për vërtetësinë, besueshmërinë dhe kompetencën e burimit, ose nëse informacioni është siguruar nga një burim, i cili në të kaluarën ka rezultuar të jetë i besueshëm në të gjitha rastet;

b) Burimi nga është marrë informacioni, në shumicën e rasteve, ka rezultuar të jetë i besueshëm;

c) Burimi nga është marrë informacioni, në shumicën e rasteve, ka rezultuar të jetë jo i besueshëm;

x) Besueshmëria e burimit nuk mund të vlerësohet.

2. Kur informacioni është siguruar nga palët, mbi bazën e kësaj Marrëveshjeje, besueshmëria e informacionit do të përcaktohet sa më shumë të jetë e mundur në bazë të kritereve të mëposhtme:

1) Informacion, saktësia e të cilit nuk vihet në dyshim;

2) Informacioni i njohur personalisht në burim, por nuk dihet personalisht zyrtari që e ka kaluar këtë informacion;

3) Informacioni që nuk dihet personalisht në burim, por konfirmohet nga informacione të tjera tashmë të regjistruara;

4) Informacioni, i cili nuk është i njohur personalisht në burim dhe nuk mund të vërtetohet.

3. Nëse ndonjëra prej palëve, mbi bazën e informacionit në zotërim të tyre, arrijnë në përfundimin se vlerësimi i informacionit të siguruar nga pala tjetër ka nevojë për korrigjim, duhet të informojë palën tjetër dhe të përpiqen për të rënë dakord për një ndryshim të vlerësimit. Nëse nuk ka një marrëveshje të tillë, asnjëra palë nuk duhet të ndryshojë vlerësimin e informacionit të marrë.

4. Nëse njëra palë merr informacion pa një vlerësim, duhet të përpiqet sa më shumë që të jetë e mundur dhe në marrëveshje me palën transmetuese, për të vlerësuar besueshmërinë e burimit të informacionit apo informacionin mbi bazën e informacionit që tashmë kanë në zotërim.

5. Palët mund të bien dakord, në terma të përgjithshëm, mbi vlerësimin e llojeve të specifikuar të informacionit dhe burimet e specifikuar, të cilat duhet të parashtrihen në Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Europolit. Në rast se informacioni është siguruar mbi bazën e këtyre marrëveshjeve, kjo duhet të tregohet bashkë me informacionin.

6. Nëse nuk mund të kryhet një vlerësim i besueshëm apo nuk ekziston një marrëveshje, në terma të përgjithshëm, informacioni duhet të vlerësohet sipas paragrafit 1(X) dhe paragrafit 2(4), të përmendur më lart.

Neni 16
Siguria e të dhënave

Palët duhet të garantojnë që informacioni i marrë apo i shkëmbyer të jetë i mbrojtur nga masa teknike dhe organizative. Këto masa duhet të jenë të nevojshme vetëm në rastet kur përpjekja që ato bëjnë, është në përpjesëtim me objektivin që kanë parashikuar për të arritur në lidhje me mbrojtjen dhe do të vendosin:

1. Për të mos lejuar persona të paautorizuar të kenë akses ndaj pajisjeve të përpunimit të të dhënave, të cilat përdoren për përpunimin e të dhënave personale (kontrolli i hyrjes së pajisjeve);

2. Për të parandaluar leximin e paautorizuar, kopjimin, modifikimin apo heqjen e të dhënave nga mjetet e komunikimit (kontrolli i të dhënave të mjeteve të komunikimit);

3. Për të parandaluar futjen e paautorizuar të të dhënave personale dhe kontrollin e paautorizuar, modifikimin apo fshirjen e të dhënave personale të ruajtura (kontrolli i të dhënave të ruajtura);

4. Për të parandaluar përdorimin e përpunimit automatik të të dhënave, sistemit të përpunimit nga persona të paautorizuar, pajisjet e komunikimit (kontrolli i përdoruesve);

5. Për të garantuar që personat e autorizuar që përdorin një sistem të përpunimit automatik të të dhënave, të kenë akses vetëm te të dhënat personale për të cilat janë të autorizuar (kontrolli i aksesit të të dhënave);

6. Për të garantuar që është e mundur të verifikohet dhe të vendoset se cilit organ i janë transmetuar apo do t'i transmetohen të dhënat personale, duke përdorur mjetet e komunikimit të të dhënave (kontrolli i komunikimit);

7. Për të siguruar që është e mundur të verifikohet dhe të vendoset se cilat nga të dhënat personale kanë hyrë dhe janë parë (konsultuar) në sistemin automatik të përpunimit të të dhënave, kur dhe nga cilët persona kanë hyrë dhe janë parë (konsultuar) këto të dhëna personale (kontrolli i hyrjes së të dhënave);

8. Për të parandaluar leximin e paautorizuar, kopjimin, modifikimin apo fshirjen e të dhënave personale gjatë transferimit apo transportit të pajisjeve të komunikimit të të dhënave (kontrolli i transportit);

9. Për të garantuar që sistemet e instaluar, për sa i përket ndërprerjes, mund të riparohen menjëherë (rigjenerimi);

10. Për të garantuar që funksioni i sistemit të operojë pa asnjë defekt, që shfaqja e defekteve të funksionit të raportohet menjëherë (besueshmëria) dhe që të dhënat personale, të ruajtura, nuk mund të prishen nga keqfunksionimi i sistemit (integriteti).

KREU IV
FORMA TË TJERA BASHKËPUNIMI
Neni 17
Bashkimi me grupet e analizës

1. Europoli mund të ftojë ekspertë nga Republika e Shqipërisë, të lidhur me aktivitetet e grupit të analizës dhe sipas kushteve të parashtruara në nenin 14(8) të vendimit të Këshillit të Europolit, hartohet një marrëveshje asociimi për këtë qëllim.

2. Në veçanti, këto marrëveshje asociimi do t'i lejojnë ekspertët e asociuar:

a) për të marrë pjesë në takimet e grupit të analizës;

b) për t'u informuar nga Europoli, sipas kërkesës, mbi zhvillimin e dosjeve analitike të punës përkatëse; dhe

c) për të marrë rezultatet e analizave që lidhen me Republikën e Shqipërisë, duke respektuar kushtet e nenit 19(2) dhe nenit 24(1) të vendimit të Europolit, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 18
Pjesëmarrja në ekipet e përbashkëta hetimore

Republika e Shqipërisë dhe Europoli duhet t'i ofrojnë njëra-tjetrës mbështetje për të lehtësuar krijimin dhe operimin e ekipeve të përbashkëta hetimore.

KREU V
KONFIDENCIALITETI I INFORMACIONIT
Neni 19
Parimet e sigurisë dhe të konfidencialitetit

Secila palë duhet:

1. Të mbrojë dhe të ruajë informacionin e paklasifikuar, sipas Marrëveshjes së Memorandumit të Bashkëpunimit, referuar në nenin 20, me përjashtim të informacionit, i cili është shënuar qëllimisht apo është qartësisht i njohur si informacion publik, nga masa të ndryshme, duke përfshirë detyrimin e diskrecionit dhe të konfidencialitetit, duke limituar aksesin për personelin e autorizuar dhe masat e përgjithshme teknike dhe procedurale;

2. Të mbrojë dhe të ruajë informacionin e klasifikuar sipas Marrëveshjes së Memorandumit të Bashkëpunimit, të referuar në nenin 20;

3. Të garantojë që ka një organizim, kuadër dhe masa të sigurta në vend. Palët bashkërisht do të pranojnë dhe do të zbatojnë parimet bazë dhe standardet minimale të zbatuara në sistemet e tyre përkatëse të sigurisë dhe procedurat për të garantuar që të paktën një nivel ekuivalent mbrojtjeje të miratohet për informacionin e klasifikuar në bazë të kësaj Marrëveshjeje;

4. Të garantojë që zyrat ku mbahet ky informacion, sipas Marrëveshjes, të kenë një nivel të përshtatshëm të sigurisë fizike, në përputhje me kuadrin përkatës ligjor të palëve;

5. Të garantojë që aksesit dhe zotërimi i informacionit të jetë i kufizuar për ata persona, të cilët për arsye të detyrimeve të tyre kanë nevojë të njihen me një informacion të tillë apo ta trajtojnë atë;

6. Të garantojë që të gjithë personat, të cilët gjatë detyrave të tyre zyrtare kanë nevojë për akses, si dhe personat, detyrat apo funksionet e të cilëve mund ta lejojnë aksesin për informacionin e klasifikuar, t'i nënshtrohen projektimit të një sigurie bazë, në përputhje me kuadrin ligjor të palës;

7. Të jenë përgjegjës për zgjidhjen e një niveli të përshtatshëm klasifikimi për informacionin që ata i japin palës tjetër;

8. Të garantojë që informacioni i klasifikuar, sipas Marrëveshjes, të mbajë nivelin e klasifikimit që i është dhënë atij nga pala e origjinës. Pala marrëse duhet të mbrojë dhe të ruajë informacionin e klasifikuar sipas kuadrin të saj ligjor, për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, duke mbajtur një nivel ekuivalent klasifikimi;

9. Të mos përdorë apo të lejojë përdorimin e informacionit të klasifikuar, sipas Marrëveshjes, përveç qëllimeve dhe brenda çdo kufizimi të konstatuar nga/apo në emër të hartuesit, pa miratimin në formë të shkruar të hartuesit;

10. Të mos zbulojë apo të mos lejojë zbulimin e informacionit të klasifikuar, sipas Marrëveshjes, për palët e treta, pa marrë më parë miratimin në formë të shkruar të krijuesit.

Neni 20

Memorandum Mirëkuptimi për Konfidencialitetin dhe Sigurimin e Informacionit

Mbrojtja e informacionit të shkëmbyer ndërmjet palëve, duhet të rregullohet me anë të një Memorandumi Mirëkuptimi për Besueshmërinë dhe Sigurimin e Informacionit për zbatimin e parimeve të përmendura në këtë kre. Një memorandum i tillë duhet të përfshijë, në veçanti, dispozitat e organizimit të sigurisë së palëve, edukimin dhe trajnimin, standardet e projektimit të sigurisë, tabelën e ekuivalencave, trajtimin e informacionit të klasifikuar dhe vlerat e sigurimit të informacionit. Shkëmbimi i informacionit të klasifikuar është kushtëzues në konkluzionet e Memorandumit të Mirëkuptimit për Besueshmërinë dhe Sigurimin e Informacionit.

KREU VI

MOSMARRËVESHJET DHE PËRGJEGJËSIA

Neni 21

Përgjegjësia

1. Palët duhet të jenë përgjegjëse, në përputhje me kuadrin e tyre ligjor, për çdo dëm të shkaktuar ndaj një individit, si rezultat i gabimeve ligjore apo faktike në shkëmbimin e informacionit. Në mënyrë që të shmanget

përgjegjësia e tij, sipas kuadrin përkatës ligjor, përballë një pale të dëmtuar, asnjëra nga palët nuk mund të deklarojë se pala tjetër ka përcjellë informacion të pasaktë.

2. Nëse këto gabime ligjore apo faktike kanë ndodhur si rezultat i përcjelljes/komunikimit në mënyrë të gabuar të informacionit apo të dështimit të njërës palë në përmbushjen e detyrimeve të tyre, ato duhet të jenë përgjegjëse që, në bazë të një kërkesë, të shlyejnë, sipas kërkesës, çdo shumë të paguar si kompensim, sipas paragrafit 1 të përmendur më lart, përveçse ky informacion është përdorur nga pala tjetër në kundërshtim me këtë Marrëveshje.

3. Palët nuk duhet t'i kërkojnë njëra-tjetrës të shlyejnë dëmet ndëshkuese apo jo të kompensueshme sipas paragrafëve 2 dhe 3 më lart.

Neni 22

Zgjidhja e konflikteve

1. Të gjitha konfliktet, të cilat lindin si rezultat i interpretimit apo i aplikimit të kësaj Marrëveshjeje, duhet të zgjidhen me anë të konsultimit dhe të negociatave ndërmjet përfaqësuesve të palëve.

2. Në rast dështimi serioz të secilës palë, për t'u pajtuar me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, apo kur një palë çmon se dështime të tilla do të vërehen në të ardhmen, çdonjëra prej palëve përkohësisht mund të pezullojë aplikimin e kësaj Marrëveshjeje, deri sa të jetë në vazhdim e sipër zbatimi i paragrafit 1. Detyrimet e lindura mbi palët, sipas kësaj Marrëveshjeje, do të mbeten në fuqi.

KREU VII

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 23

Linja e sigurt e komunikimit

Vendosja, zbatimi dhe operimi i një linje të sigurt komunikimi, për qëllim shkëmbimin e informacionit ndërmjet Europolit dhe Republikës së Shqipërisë, duhet të rregullohet në një memorandum mirëkuptimi.

Neni 24

Shpenzimet

Palët duhet t'i mbulojnë vetë shpenzimet e tyre, të cilat do të lindin gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, nëse nuk është e parashikuar ndryshe në këtë Marrëveshje.

Neni 25

Amendimet dhe shtojcat

1. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me shkrim, në çdo kohë, me miratim të përbashkët ndërmjet palëve. Çdo ndryshim duhet të marrë miratimin e Këshillit të Bashkimit Europian.

2. Aneksat e kësaj Marrëveshjeje, si dhe dispozitat e nenit 3 (3) mund të ndryshohen përmes shkëmbimit të notave ndërmjet palëve.

3. Pa cenuar paragrafin 1, për ndryshimet e anekseve të kësaj Marrëveshjeje mund të bihet dakord pa miratimin e Këshillit të Bashkimit Europian.

4. Palët mund të hyjnë në konsultime në lidhje me ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje apo anekset e saj, me kërkesën e secilës prej tyre.

Neni 26

Hyrja në fuqi dhe vlefshmëria

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën në të cilën Europolin njofton Republikën e Shqipërisë, me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike, me anë të të cilave ka marrë dhe ka pranuar njoftimin e Republikës së Shqipërisë, se procesi i brendshëm i ratifikimit është plotësuar.

Neni 27

Përfundimi i marrëveshjes së bashkëpunimit strategjik

Marrëveshja e bashkëpunimit strategjik, nënshkruar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Europolit, më 5 shkurt 2007, dhe Marrëveshja për oficerët e ndërlidhjes, nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Europolit, më 26 shkurt 2009, do të shfuqizohen menjëherë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Efekti ligjor i të dyja Marrëveshjeve do të mbetet në fuqi.

Neni 28

Përfundimi i Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje mund të përfundohet mbi bazë të njoftimit me shkrim nga secila palë, tre muaj përpara.

2. Në rast të përfundimit të Marrëveshjes, palët duhet të arrijnë një marrëveshje për përdorimin dhe ruajtjen e vazhdueshëm të informacionit, që është komunikuar ndërmjet tyre. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, të dyja palëve u jepet e drejta për të kërkuar që informacioni, që është komunikuar, të asgjësohet apo t'i kthehet palës transmetuese.

3. Pa cenuar paragrafin 1, efektet ligjore të kësaj Marrëveshjeje do të mbeten në fuqi.

Nënshkruar në Hagë, më 9.12.2013, në dy kopje, në shqip dhe në anglisht, ku secili tekst është njëllor autentik.

Për Republikën e
Shqipërisë:
MINISTRI I PUNËVE TË
BRENDSHME
Saimir Tahiri

Për Europolin:
DREJTORI
Rob Wainwright

ANEKSI I FUSHAT E KRIMIT

Kompetencat e Europolit duhet të mbulojnë krimin e organizuar, terrorizmin dhe format e tjera të krimeve të rënda, të renditura më poshtë, duke ndikuar mbi dy apo më shumë shtete anëtare, në një mënyrë që të kërkojë një qasje të përbashkët nga shtetet anëtare, sipas shkallës, rëndësisë dhe pasojave të shkeljeve penale.

Format e tjera të krimit të rëndë të përmendura, janë si më poshtë:

- trafikimi i paligjshëm i drogave;
- aktivitetet e paligjshme të pastrimit të parave;
- krimi i lidhur me substancat nukleare dhe radioaktive;
- kontrabandimi i paligjshëm i emigrantëve;
- trafikimi i qenieve njerëzore;
- krimi i mjeteve motorike;
- vrasjet, plagosjet e rënda në trup;
- tregtia e paligjshme e organeve dhe indeve njerëzore;
- rrëmbimi, pengmarrja dhe mbajtja e paligjshme e personave;
- racizmi dhe ksenofobia;
- vjedhja e organizuar;
- trafikimi i paligjshëm në vlerat kulturore, duke përfshirë veprat antike dhe veprat e artit;
- mashtrimi dhe zhvatja;
- shantazhi dhe shfrytëzimi;
- falsifikimi dhe pirateria e produkteve;
- falsifikimi i dokumenteve administrative dhe trafikimi me anë të atyre;
- falsifikimi i parave dhe i mënyrave të pagesave;
- krimi kompjuterik;
- korrupsioni;
- trafikimi i paligjshëm i armëve, i municioneve dhe i eksplozivëve;
- trafikimi i paligjshëm i specieve në zhdukje;
- trafikimi i paligjshëm i bimëve në zhdukje dhe i shumëllojshmërive;
- krimi mjedisor;
- trafikimi i paligjshëm i substancave hormonale dhe i promovuesve të tjerë të rritjes.

Në lidhje me format e krimeve të renditura më lart, në bazë të kësaj Marrëveshjeje:

a) "Krimi i lidhur me substancat nukleare dhe radioaktive" do të thotë veprat penale të renditura në nenin 7(1) të Konventës së Mbrojtjes Fizike nga Materialet Nukleare, e firmosur në Vjenë dhe në Nju-Jork, më 3 mars 1980, dhe në lidhje me materialet nukleare dhe radioaktive, të përcaktuara në nenin 197 të Traktatit, i cili vendos Komitetin Atomik Europian dhe direktivat e Këshillit 96/29/Euroatom, të datës 13 maj 1996, në të cilën formulohen standardet bazë të sigurisë për mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe publikut kundër reziqeve, të

cilët vijnë nga rrezatimi radioaktiv i jonizuar¹;

b) “Kondrabanda (hyrja) e paligjshme e imigrantëve” do të thotë aktivitete, të cilat kanë si qëllim të lehtësojnë, për përfitim financiar, hyrjen, rezidencën apo punësimin në territorin e shteteve anëtare, në kundërshtim me rregullat dhe kushtet e shteteve anëtare;

c) “Trafikimi i qenieve njerëzore” do të thotë rekrutimi, transporti, transferimi, strehimi apo rritja e personave, me anë të kërcënimit, përdorimit të forcës apo formave të tjera shtrënguese, të grabitjeve, mashtrimit, të abuzimit të autoritetit apo të një pozicioni cenueshmërie apo të dhënies dhe marrjes së pagesave, si edhe përfitimeve për të marrë miratimin e një personi që të ketë kontroll mbi një person tjetër, për qëllim shfrytëzimin. Shfrytëzimi duhet të përfshijë minimumi shfrytëzimin e prostitucionit apo të formave të tjera të shfrytëzimit seksual, prodhimin, shitjen apo shpërndarjen e materialeve pornografike mbi fëmijët, punën e detyruar apo shërbimet, skllavërinë apo praktikat e ngjashme me skllavërinë apo heqjen e organeve;

d) “Krimi i mjeteve motorike” do të thotë vjedhje apo përdorim i mjeteve motorike, kaminonë, gjysmërimorkio, autobusë, motoçikleta, furgonë dhe mjete bujqësore, mjete pune dhe pjesë pajisjesh të ngjashme, si edhe marrja dhe fshehja e objekteve të tilla;

e) “Aktivitetet e paligjshme të pastrimit të parave” do të thotë veprat penale, të renditura në nenin 6(1) dhe (3) të Konventës së Këshillit të Europës mbi Pastrimin, Kërkimin, Konfiskimin dhe Sekuestrimin e të Ardhurave nga Krimi, të nënshkruar në Strasburg, më 8 nëntor 1990;

f) “Trafikimi i paligjshëm i drogave” do të thotë veprat penale, të renditura në nenin 3(1) të Konventës së Kombeve të Bashkuara, të datës 20 dhjetor 1988, kundër Trafikimit të Paligjshëm të Substancave Narkotike dhe Psikotrope dhe të dispozitave, të cilat ndryshojnë apo zëvendësojnë Konventën.

Format e krimit, të referuara në nenin 3 dhe në këtë aneks, duhet të vlerësohen nga autoritetet kompetente në përputhje me ligjin e shteteve.

ANEKSI II

AUTORITETET KOMPETENTE DHE PIKAT KOMBËTARE TË KONTAKTIT

Pika kombëtare e kontaktit për Republikën e Shqipërisë, për të vepruar si pika qendrore e kontaktit ndërmjet Europolit dhe autoriteteve të tjera kompetente të Republikës së Shqipërisë është përcaktuar

Njësia Kombëtare e Europolit në Policinë e Shtetit Shqiptar;

Autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë përgjegjëse sipas ligjit kombëtar për parandalimin dhe luftën kundër veprave penale, referuar në nenin 3(1) të kësaj Marrëveshjeje, janë si më poshtë:

1. Ministria e Brendshme (Policia e Shtetit Shqiptar);
2. Ministria e Financës (Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave);
3. Shërbimi Informativ i Shtetit;
4. Prokuroria e Përgjithshme;
5. Ministria e Mbrojtjes (Agjencia e Inteligjencës së Mbrojtjes).

ANEKSI III

OFICERËT NDËRLIDHËS

Oficerët ndërlidhës

Neni 1

Detyrat e oficerit ndërlidhës të Republikës së Shqipërisë

Detyra e oficerëve ndërlidhës të Republikës së Shqipërisë (të referuar këtu si “oficer ndërlidhës”) është të mbështesin dhe të koordinojnë bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Europolit dhe shteteve anëtare të Bashkimit Europian. Në veçanti, oficeri ndërlidhës duhet të jetë përgjegjës për mbështetjen e kontakteve ndërmjet Europolit, Republikës së Shqipërisë dhe shteteve anëtare të BE-së, si edhe të lehtësojë shkëmbimin e informacionit. Çdo shkëmbim informacioni ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe njësive kombëtare të Europolit, duhet të jetë në përputhje me ligjin kombëtar përkatës.

Neni 2

Statusi i oficerëve ndërlidhës

Oficeri ndërlidhës duhet të shikohet si përfaqësues zyrtar i Republikës së Shqipërisë për sa i përket Europolit. Europoli duhet të lehtësojë qëndrimin:

1. e oficerëve ndërlidhës në Holandë, për aq kohë sa të jetë brenda mundësive të tij. Në veçanti, duhet të bashkëpunojë me autoritetet përkatëse holandeze në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me privilegjet dhe imunitetin për aq kohë sa të jetë e mundur.

2. Oficeri ndërlidhës duhet të jetë përfaqësues i autoriteteve në Republikën e Shqipërisë përgjegjëse për parandalimin dhe luftën kundër veprave penale sipas Marrëveshjes së Bashkëpunimit Strategjik dhe Operacional ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Europiane (e referuar këtu si “Marrëveshja”).

Neni 3

Metodat e punës

1. Çdo shkëmbim informacioni ndërmjet Europolit dhe oficerit ndërlidhës, duhet të kryhet në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes.

¹ OJ L 159, 29.6.1996, P.1

2. Kur shkëmbëhet informacioni, oficeri ndërlidhës duhet të komunikojë drejtpërdrejt me Europolin nëpërmjet përfaqësuesve të caktuar për këtë qëllim nga Europoli. Oficeri ndërlidhës nuk duhet të ketë akses të drejtpërdrejtë në dosjet e të dhënave të Europolit.

Neni 4 Konfidencialiteti

1. Republika e Shqipërisë duhet të garantojë që oficeri ndërlidhës të monitorohet në një nivel kombëtar të përshtatshëm për oficerin e kontaktit, të ketë mundësi të merret me informacionin e siguruar nga, ose nëpërmjet Europolit, i cili është pjesë e një kërkesë të veçantë të konfidencialitetit, në përputhje me kapitullin V të kësaj Marrëveshjeje.

2. Europoli duhet të asistojë oficerin ndërlidhës, duke i siguruar burimet e mundshme për të përmbushur çdo kërkesë, në lidhje me mbrojtjen e fshehtësisë së informacionit të shkëmbyer me Europolin.

Neni 5 Çështjet administrative

1. Oficeri ndërlidhës duhet të pajtohet me rregullat e brendshme të Europolit, pa cenuar ligjin e tij kombëtar. Duke përmbushur detyrat e tij, oficeri ndërlidhës duhet të procedojë në përputhje me ligjin e tij kombëtar mbi mbrojtjen e të dhënave.

2. Oficeri ndërlidhës duhet të mbajë të informuar Europolin mbi orët e punës dhe detajet e kontaktit, në rast emergjence. Oficeri ndërlidhës duhet, gjithashtu, të informojë Europolin për çdo qëndrim të gjatë larg nga zyrat qendrore të Europolit.

Neni 6 Përgjegjësia dhe rastet e konfliktit

1. Republika e Shqipërisë duhet të jetë përgjegjëse për çdo dëm të shkaktuar nga oficerët e kontaktit për materialet në pronësi të Europolit. Çdo dëm i tillë do të shlyhet në vend nga Republika e Shqipërisë, mbi bazën e një kërkesë të vërtetuar sipas rregullave nga Europoli. Në rast mosmarrëveshjes në lidhje me shlyerjen, do të zbatohet neni 22 i Marrëveshjes.

2. Në rast konflikti ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Europolit, apo ndërmjet oficerit ndërlidhës dhe Europolit, drejtorit të Europolit i jepet e drejta të mos lejohet aksesin e oficerit ndërlidhës në ndërtesën e Europolit, ose t'i garantojë një akses të tillë sipas kushteve dhe kufizimeve të veçanta.

3. Kur ekziston një konflikt serioz ndërmjet Europolit dhe oficerit ndërlidhës, drejtorit të Europolit i jepet e drejta t'i paraqesë një kërkesë Republikës së Shqipërisë për zëvendësimin e tij.

i) Për Republikën e Shqipërisë, si palë nënshkruese e Konventës nr. 108 të Këshillit të Europës, fjala "transmetim" (transmision) kuptohet "transferim" (transfero), duke iu referuar Konventës së sipërcituar.

UDHËZIM Nr. 6/3, datë 8.4.2014

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 17, DATË 13.5.2008, "PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 17, datë 13.5.2008, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 19.4, paragrafi 1 zëvendësohet me këtë përmbajtje:

"1) Shpenzimet e karburantit, përveçse kur qëllimi i veprimtarisë ekonomike është blerja e karburantit me qëllim për ta shitur atë.

Për qëllime të veprimtarisë ekonomike të tatueshme, kreditimi i TVSH-së së gazoilit të blerë për këtë qëllim, është i lejueshëm deri në normativat e listuara më poshtë, mbi bazën e treguesit të përcaktuar sipas peshës specifike që blerjet për gazoil zënë në raport me qarkullimin e kryer për qëllime të veprimtarisë ekonomike.

Normativat e kreditimit të TVSH-së së gazoilit

I. Ndërtim

a) Prodhim materiale inerte deri më 33%;

b) Ndërtim shtrim rrugësh deri më 32%;

c) Ndërtim banesash dhe objektesh të ndryshme deri më 8%;

ç) Prodhim betoni deri më 14%;

d) Gërmime/shpime deri më 25%;

dh) Prodhim tullash dhe tjegullash 33%.

II. Transport

a) Transport udhëtarësh deri më 43%;

b) Transport mallrash deri më 38%;

c) Transport mallrash me mjete teknologjike 78%.

III. Shërbime

- a) Autoshkolla deri më 25%;
- b) Shërbime pastrimi qyteti deri më 30%;
- c) Peshkimi deri më 10%.

III. Tregti deri më 3%

IV. Të tjera (të palistuara më lart) deri më 2%

Barra e provës për të provuar qëllimin e përdorimit të gazoilit për qëllime të veprimtarisë ekonomike të tatueshme, bie mbi personin e tatueshëm.

Nëse nga kontrolli i thelluar konstatohet që personi i tatueshëm me pa të drejtë ka kredituar TVSH-në lidhur me blerjen e gazoilit, duke mos e justifikuar atë, Drejtoria Rajonale Tatimore aplikon të gjitha sanksionet që parashikon legjislacioni tatimor në fuqi.”.

2. Pika 19.5 shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 16 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006